



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Nr. 03/8 Prot.

Lezhë, më 10.3. 2020

VENDIM

Nr. 8, datë 03.03.2020

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR, SHFRYTËZIM TË**  
**MATERIALEVE INERTE, NJËSIA ADMINISTRATIVE SHËNKOLL, BASHKIA**  
**LEZHË, PËR SUBJEKTIN "ANK" SH.P.K**

Në mbështetje të shkronjës "b" të pikës 2, të nenit 12, pika 1 neni 44, pikës 2 të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar, V.K.M –së Nr. 696, datë 30.10.2019 "Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre" dhe të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore", me propozimin e Zyrës së Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm – Erzen – Mat, Këshilli i Basenit Ujor Mat.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes "Për shfrytëzim të materialeve inerte" subjektit "ANK" SH.P.K. sipas kushteve të mëposhtme:
  - Nuk duhet të shfrytëzohen inerte nën pasqyrën aktuale të ujit;
  - Të realizohet një pus për monitorimin e nivelit të ujit në tarracën aluviale të lumit Mat, në një pikë të përshtatshme në zonën e shfrytëzimit;
  - Të aplikojë për leje hapje pusi dhe autorizim përpara fillimit të zbatimit të kësaj lejeje;
  - Të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme nivelin e ujrave nëntokësore dhe të përgatisi një raport mujor drejtuar SHGJSH dhe AMBU-së;
  - Në rastet e prishjes së regjimit sasior dhe cilësor të cilat vërtetohen se kanë shfrytëzimi duhet të ndërpriten në mënyrë të menjëhershme punimet;

- Materialet inerte të nxjerra në zbatim të kësaj leje nuk lejohet të përdoren për qëlime të tjera përveç objektit të kontratës;
- Të inforohet AMBU me listën e përditësuar për çdo muaj për pronësinë dhe nënkontratat me mbajtësin e kësaj leje për mjete që do punojnë në lumë.

1. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Ishëm – Erzen – Mat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**

Anastasi Meçi



**KRYETAR**

Gjokë Jaku

